

Mars 2025

Nr (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
9.	04.03.2025	<p>Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1. Cilët ishin përfaqësuesit e Shqipërisë në këtë panel? (ju lutem listoni emrat e personave dhe funksionin e tyre)</p> <p>2. Cila është kostoja totale e shtetit shqiptar për të qenë prezent në panairin e turizmit në Berlinin?</p>	13.03.2025	<p>Në vijim e-mail-it tuaj, ku kërkohet informacion lidhur me panairin ndërkombëtar të turizmit ITB Berlin 2025, në të cilin Shqipëria u prezantua nën statusin ekskluziv “<i>Host Country</i>”, ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>1. Përfaqësuesit e Shqipërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Kombëtare e Turizmit - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve - Korporata e Investimeve Shqiptare - Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor - Unioni Turistik Shqiptar - Shoqata Shqiptare e Turoperatorëve - GIZ - AirAlbania <p>2. Buxheti i akorduar për organizimin e panairit ITB Berlin 2025 është sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/ 2024 “<i>Për buxhetin e vitit 2025</i>”.</p>	Përfunduar	0

10	04.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: - Shpenzimet sipas zërave përkatës për Panairin e Turizmit ne Berlin 2025	13.03.2025	Në vijim të e-mail-it, ku kërkohet informacion lidhur me panairin ndërkombëtar të turizmit ITB Berlin 2025, në të cilin Shqipëria u prezantua nën statusin ekskluziv “ <i>Host Country</i> ”, ju informojmë se buxheti i akorduar për organizimin e panairit ITB Berlin 2025 është sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2024 “ <i>Për buxhetin e vitit 2025</i> ”.	Përfunduar	0
11.	10.03.2025	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie te informacionit dhe kopje te dokumentacionit zyrtare	17.03.2025	Kthyer përgjigje me shkresë	Përfunduar	0
12	12.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: programin ALBAdapt, që financohet nga Fondi i Gjellbër i Klimës. 1- A është finalizuar marrëveshja e financimit? Nëse po, të më vendoset në dispozicion marrëveshja e financimit e nënshkruar në kuadër të këtij programi. 2- Kur parashikohet të nisë disbursimi i financimit prej 35 mln euro? 3- Në sa transhe parashikohet të kryhet disbursimi i fondit? 4- Cilat janë ndërhyrjet që parashikohet të financohen përmes këtij programi? 5- Sa është kohëzgjatja e programit?	27.03.2025	1- A është finalizuar marrëveshja e financimit? Nëse po, të më vendoset në dispozicion marrëveshja e financimit e nënshkruar në kuadër të këtij programi. Programi ALBAdapt bashkë financohet nga Fondi i Gjellbër për Klimën (GCF), Qeveria Shqiptare, Qeveria Zvicereane dhe Qeveria Gjermane. Ky financim jepet bazuar në një propozim të programit që është miratuar vitin e kaluar. Ju mund të gjeni propozimin e miratuar në ne website-n zyrtar te MTM-se dhe te "Fondit te gjelbër te klimës" (për reference linqet jepen në fund te këtij materiali) . 2- Kur parashikohet të nisë disbursimi i financimit prej 35 mln euro? Programi ka nisur në dhjetor 2024 dhe është planifikuar të zgjasë deri në qershor 2031. Programi është në fazën e fillimit, gjatë të cilës po realizohen takime dhe workshope planifikuese me të gjithë përfituesit e drejtpërdrejt në program. Disbursimi do të ndodhë në përputhje me fazat e zbatimit të programit. 3- Në sa transhe parashikohet të kryhet disbursimi i fondit? Disbursimi do të ndodhë në bazë të fazave të zbatimit të programit, të cilat miratohen nga Fondi i Gjellbër për Klimën. 4- Cilat janë ndërhyrjet që parashikohet të financohen përmes këtij programi?	Përfunduar	0

				<p>Projekti ALBAdapt do të rrisë reziliencën klimatike të popullsisë shqiptare përmes gjenerimit, koordinimit dhe përdorimit efektiv të informacionit klimatik - i mbështetur nga një sistem kombëtar hidro-meteorologjik dhe nga një kuadër kombëtar funksional i shërbimeve klimatike - dhe një sistemi paralajmërimesh të hershme të orientuar tek popullsia, që u lejojnë sektorëve ekonomikë dhe komuniteteve lokale (duke përfshirë edhe grupet vulnerabël) që të ndërmarrin veprime të hershme.</p> <p>Komponenti 1 i projektit do të zbatojë aktivitete themelore që mbështesin përmirësimin e sistemit kombëtar hidro-meteorologjik, shoqëruar me shërbime platformash komplementare: një sistem informacioni klimatik kombëtar dhe një platforme si ndërfaqe përdoruesi (UIP). Komponenti 2 do të ngrëjë një sistem të qëndrueshëm, të orientuar nga popullsia për paralajmërimet e hershme me bazë disa rreziqe, i cili do të jetë fort i lidhur me sistemin kombëtar hidrometeorologjik dhe do të mbështesë hapat e parë të kalimit drejt parashikimit të bazuar në impakte dhe reagimit të bazuar në parashikim. Komponenti 3 do të mbështesë dy aspekte kritike të investimeve të lidhura me klimën: (i) përfshirjen e sektorit privat dhe inovacionit në shërbimet klimatike, dhe (ii) investimet në masat përshtatëse të bazuara në ekosistem .</p> <p>5- Sa është kohëzgjatja e programit? Dhjetor 2024 – Qershor 2031</p> <p>Më shumë informacion mbi programin gjeni këtu: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit SAP041: ALBAdapt – Climate Services for a Resilient Albania Green Climate Fund</p>		
13	10.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: · A janë kryer analiza mbi përbërjen dhe nivelin e rrezikshmërisë së 2000 ton	20.03.2025	Në vijim te emailit tuaj ju bëjmë me dije se çështja është objekt hetimi nga Prokuroria e Durrësit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është në bashkëpunim me organet e drejtësisë.	Përfunduar	0

		<p>mbetjeve te kthyer nga Tajlanda ne Porto Romano? Nëse po, cilat janë rezultatet dhe cili është laborator i zgjedhur? · Cilat institucione ose kompani janë përfshirë në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre mbetjeve? · A janë marrë masa për të parandaluar ndotje të mëtejshme dhe ndikimin e mundshëm në ujërat nëntokësore apo tokën bujqësore përreth? · Si sigurohet përputhshmëria e veprimeve të institucioneve shqiptare me detyrimet e Konventës së Bazelit në këtë rast?</p>				
14.	17.03.2025	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Na vendosni në dispozicion një kopje të biletave që janë prerë nga ana e shtetit shqiptarë për personat që kanë qenë prezentë në panair? 2. Na vendosni në dispozicion listën e personave pjesëmarrës në panair? 3. Sa ka qenë kostoja e shtetit shqiptar për të qenë i pranishëm në panair? 		Në proces		

		4. Cila ishte salla në të cilën u promovua shteti shqiptar dhe sa ishte kostoja totale e tij?				
15	19.03.2025	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Sa është numri total i personave që kanë përfituar nga skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit të tyre gjatë periudhës janar- dhjetor 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?</p> <p>2. Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) që kanë përfituar nga skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit të tyre gjatë periudhës janar- dhjetor 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?</p>	27.03.2025	<p>1.Numri total i personave që kanë përfituar nga skema e mbështetjes financiare për projektet e turizmit për periudhën janar – dhjetor 2024 janë 37 persona. Ku 18 prej tyre janë femra dhe 19 meshkuj.</p> <p>2. Numri i të rinjve (15-29 vjeç) qe kane përfituar nga skema e mbështetjes financiare për projektet e turizmit për periudhën janar – dhjetor 2024 është 2 dhe janë meshkuj.</p>	Përfunduar	0
16.	20.03.2025	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: Gjatë datave 4-6 Mars të këtij viti, 2025, Shqipëria është prezentë në panairin e turizmit në Berlin, ITB.</p> <p>Pjesëmarrës në këtë panair janë përfaqësues të destinacioneve turistike, operatorë turistikë,</p>	02.04.2025	<p>1. Përfaqësuesit e Shqipërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Kombëtare e Turizmit - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve - Korporata e Investimeve Shqiptare - Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor - Unioni Turistik Shqiptar - Shoqata Shqiptare e Turoperatorëve - GIZ 	Përfunduar	0

		<p>kompani ajrore, investitorë dhe ekspertë të kësaj industrie.</p> <p>1. Cilët ishin përfaqësuesit e Shqipërisë në këtë panail? (Ju lutem listoni emrat e personave dhe funksionin e tyre)</p> <p>2. Cila është kostoja totale e shtetit shqiptar për të qenë prezent në panairin e turizmit në Berlinit?</p>		<p>- Air Albania</p> <p>2. Buxheti i akorduar për organizimin e panairit ITB Berlin 2025 është sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/ 2024 “Për buxhetin e vitit 2025”.</p>		
17	20.03.2025	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit zyrtarë	27.03.2025	Kthyer përgjigje me shkresë.	Përfunduar	0
18	20.03.2025	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit zyrtarë	27.03.2025	Kthyer përgjigje me shkresë.	Përfunduar	0
19	21.03.2025	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Kopje të vendimeve të KMIM, prej 2021 e deri sot.</p> <p>2. Raportet vjetore për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në shkallë vendi, që paraqet Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave, për periudhën në fjalë.</p>		Në proces		

20	21.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: listën e njësisve të qeverisjes vendore që ka në hartuar planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që kanë nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar (në përputhje me Vendimin Nr. 418, datë 27.5.2020) dhe me planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve?		Në proces		
21	26.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2024? 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)? 3. Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2024? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë së një formë. 4. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur më		Në proces		

	<p>shumë se një formë 5. Cila ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë 6. Keni ofruar mbështetje jo financiare gjatë vitit 2024? Cila është baza ligjore/ rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje? 7. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)? 8. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2024? 9. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 11. Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga Institucioni juaj? 12. Sa përqind (%) e projektligjeve / akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-të? 13. A janë të përfshirë përfaqësues të</p>				
--	---	--	--	--	--

		OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshirë në to? 14. A janë përfshirë OJF në grupet e punës së ngritura të institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshirë në to?				
--	--	---	--	--	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

- (5) Ndihmon kërkuuesin për të njohur ecurinë e procesit.
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.